



“80 VJET DRITË DHE LAVDI: TRASHËGIMIA E SHKOLLËS ‘SKËNDERBEJ’ NË ZEMRËN E KOMBIT”



» faqe 3



LIGJI PËR STATUSIN E USHTARAKUT, VENJU: DREJT STANDARDIZIMIT TË PAGAVE ME ATO TË NATO-S

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu zhvilloi një takim për konsultim publik me përfaqësues nga shoqatat e ish-ushtarakëve, për Ligjin e statusit të ushtarakut, ku vlerësoi me shumë rëndësi gjithpërfshirjen e të gjithë aktorëve të këtij sektori, në procesin e ndryshimeve ligjore për statusin e ushtarakut...

» faqe 2



STRATEGJI, SIGURI DHE LIDERSHIP: NJË BISEDË EKSKLUZIVE ME PËRFAQËSUESIN USHTARAK KOMBËTAR NË ACO SHAPE, GJENERALMAJOR PETRIT ÇUNI

Gjeneralmajor Petrit Çuni lindi, më 6 shtator 1969, në Shkodër. Ai nisi karrierën e tij ushtarake në vitin 1984, në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Pas përfundimit të studimeve në vitin 1988, ai vazhdoi edukimin në Akademinë e Forcave Tokësore “Skënderbej”, në Tiranë, ku u diplomua në vitin 1992...

» faqe 6



TË JESH GRUA DO TË THOTË TË SFIDOSH ÇDO KUFË, TË ËNDËRROSH PA FRIKË DHE TË NDËRTOSH ME DUART E TUA ATË QË DIKUR DUKEJ E PAMUNDUR

Gratë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe në ushtritë e tjera të botës kanë dëshmuar se janë të afta të përballojnë sfida të shumta, duke balancuar jetën ushtarake me rolet e tyre si nëna, bashkëshorte dhe si gra. Pavarësisht natyrës tradicionale mashkullore të ushtrisë, gratë ushtarake kanë arritur të thyejnë barrierat dhe...

» faqe 8

Ligji për statusin e ushtarakut, Vengu: Drejt standardizimit të pagave me ato të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu zhvilloi një takim për konsultim publik me përfaqësues nga shoqatat e ish-ushtarakëve, për Ligjin e statusit të ushtarakut, ku vlerësoi me shumë rëndësi gjithpërfshirjen e të gjithë aktorëve të këtij sektori, në procesin e ndryshimeve ligjore për statusin e ushtarakut.

Nga 15 deri në 25 paga shpërblim do të marrin ushtarakët aktivë që ndërpresin punën për arsye të ndryshme, nëse miratohet projektligji i hedhur tashmë në konsultim publik, për statusin e ushtarakëve. Ushtarët dhe detarët marrin deri në 15 paga, nënoficerët 20 paga dhe oficerët deri në 25 paga.

“Kur vjen puna te rritja e kapaciteteve, modernizimin e forcave dhe industria ushtarake, të gjitha këto kapacitete nuk mund të realizohen me sukses nëse nuk investojmë të kapitali njerëzor.

Ne synojmë të krijojmë instrumente që i bëjnë të rinjtë të rrisin interesin për FA-të. Përmes ndryshimeve ligjore synojmë mbështetjen financiare për ushtarakët gjatë ushtrimit të detyrës, mbështetjen financiare dhe sociale për familjet e ushtarakëve dhe mbështetje për ushtarakët pas përfundimit të karrierës së tyre”, - u shpreh ministri Pirro Vengu. Më tej ministri Vengu tha se synimi është që FA-të të bëhen më tërheqëse për të rinjtë, teksa shtoi se pagat për 4 vitet e ardhshme do të jenë sipas standardeve të NATO-s. “Krahasuar me 10 vite më parë, kemi pesëfishuar rekrutimet. Në Akademinë e Forcave të Armatosura kemi 1100 aplikime për 100 të rekrutuar. Jemi në një situatë më të mirë. Gjithashtu pagat janë rritur ndjeshëm. Kishim pagat më të ulëta në Rajon, tani kemi pagat më të larta në Rajon dhe synimi është që për 4-vjeçarin e ardhshëm të rrisim pagat sipas standardeve të NATO-s”, - nënvizoi Vengu, teksa shtoi se është një rritje ambicioze.

Ministri Vengu tha gjithashtu se, përmes ndryshimeve ligjore do të rritet mbështetja për ushtarakët në rezervë dhe në lirim.

“Për ushtarakët që dalin në rezervë dhe lirim, i mirëpresim kritikën tuaj për ndonjë element që nuk ju pëlqen”, - tha Vengu.

Ndërkaq shqetësimet që parashtruan përfaqësuesit e ushtarakëve ishin të shumta



që nga trajtimi mjekësor, strehimi dhe krijimi i shtëpive të oficerëve.

“Projekt për një shtëpi oficerësh, disa ambiente dinjitoze, ku ju mund të keni një program ditor, do ta kemi në 12 qarqet. Sivjet do të prodhohet gjithashtu edhe një dokument i identifikimit ushtarak. Ligji i ri

sqaron mënyrën sesi kalohet në akte ligjore që japin benefitet”, - shtoi ai.

Në draft, parashikohet që përveç kredisë për strehim, ushtarakëve t'u jepet në përdorim edhe banesë në objektet e ndërtuara për qëllime strehimi nga Ministria e Mbrojtjes. Gjithashtu, parashikohet që

ushtaraku i dërguar për stërvitje, trajnim dhe kurse jashtë vendit, përveç trajtimit financiar, përfiton dietë ditore për mbulimin e shpenzimeve vetjake. Nga ana tjetër, fëmijëve të ushtarakëve të rënë në detyrë, shteti u jep bursë të plotë nëse fitojnë të drejtën për studime të larta në institucione publike.



Ministri Vengu dhe SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën SHSHPFA të Kroacisë, gjenerallejtënant Tihomir Kundid



Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën në një vizitë zyrtare shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kroacisë, gjenerallejtënant, Tihomir Kundid. Ky takim i zhvilluar në një frymë pozitive dhe produktive, vjen në kuadër të nënshkrimit në Tiranë të “Deklaratës së Përbashkët e Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes”, ndërmjet Shqipërisë,

Kroacisë dhe Republikës së Kosovës.

Dokumenti u firmos disa ditë më parë nga ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, zëvendëskryeministri dhe ministri i Mbrojtjes i Kroacisë, Ivan Anušić, dhe ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci.

Bashkëpunimi synon forcimin e aftësive mbrojtëse të tri vendeve, zhvillimin e industrisë dhe teknologjisë së Mbrojtjes, si dhe përmirësimin e ndërveprimit ushtarak në rajon.



Ky zhvillim strategjik pasqyron aleancën e ngushtë mes tri shteteve, të lidhur nga historia, sakrificat për liri dhe një vizion i përbashkët për një të ardhme të sigurt.

Gjithashtu, Shqipëria dhe Kroacia do të punojnë ngushtësisht për unifikimin e qëndrimeve politike në mbështetje të aspiratave të qytetarëve të Kosovës për integrim të plotë në strukturat rajonale dhe euroatlantike.

Shkolla Ushtarake “Skënderbej” është një institucion me histori dhe traditë të pasur në përgatitjen e brezave të ushtarakëve shqiptarë.

Këtë vit, ajo festoi 80-vjetorin e themelimit, një moment krenarie dhe reflektimi për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e saj, të cilët u mblodhën sërish së bashku në kinemanë e shkollës së tyre, tek e cila i lidhin shumë kujtime. Në ceremoninë festive të organizuar për këtë përvjetor, u mblodhën ish-nxënës, pedagogë dhe përfaqësues të lartë të Forcave të Armatosura, të cilët kujtuan me krenari vitet e tyre të formimit në këtë shkollë dhe rrugëtimin që kanë ndjekur pas diplomimit. Fjalimet e mbajtura theksuan rëndësinë e edukimit ushtarak dhe përgatitjes së brezave të rinj për të shërbyer me përkushtim ndaj atdheut.

Për këtë rast fjalën përshëndetëse e mbajti komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, i cili mes emocioneve si ish-skënderbergas dhe sot në drejtimin e institucionit të arsimimit të oficerit të ardhshëm u shpreh: “Skënderbegasit’ janë dëshmia e gjallë e vlerave njerëzore, simbol i disiplinës dhe dashurisë për atdheun. Me punën dhe integritetin tuaj, keni kontribuar për zhvillimin dhe përparimin e vendit, në çdo qelizë të shoqërisë shqiptare. Studentët e Forcave të Armatosura janë pasardhësit e denjë të brezave që po përkujtojmë sot me krenari. Ashtu si ju dikur, dhe ata përballen me sfida, disiplinë dhe përgjegjësi të uniformës ushtarake. Kjo rrugë që kanë zgjedhur nuk është thjesht një profesion por një mision. Ju jeni testament i historisë sonë”, – mbylli fjalën e tij, gjeneral brigade Nuredinaj.

Më tej të pranishmit i përshëndeti shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili tha se ndihej krenar për këtë armatë të madhe burrash dhe grash, me të cilët ka bashkudhëtuar në këtë mision të rëndësishëm. Ai shprehu gatishmërinë e tij për t’iu gjendur pranë të gjithë këtyre njerëzve me vlera të veçanta, të cilët janë asete për shoqërinë shqiptare.

Në fjalën e tij të rastit, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu përshëndeti të pranishmit, duke u shprehur se: “Shkollat ushtarake nuk janë vetëm vende arsimimi, ato janë simbole kombëtare, ku çdo përpjekje për t’i minimizuar ato përbën një akt kundër vetë identitetit kombëtar”.

Më tej do të theksonte se: “Puna dhe vepra juaj ndër dekada janë krenari e padiskutuar për brezat që vijnë pas. Kjo shkollë ia ka dalë me sukses të edukojë breza të tërë. Rrënjët e shkollës ‘Skënderbej’ kanë lëshuar prej dekadash frute në të gjithë ‘sektorët’ e shoqërisë shqiptare, duke shkruar me shkronja të arta emrin e tyre. Kjo shkollë ka luajtur një rol kyç në formimin e oficerëve dhe kuadrove të ushtrisë shqiptare, duke u shndërruar në një simbol discipline, atdhedashurie dhe profesionalizmi. Me kalimin e kohës, ajo ka nxjerrë nga gjiri i saj figura të spikatura të ushtrisë dhe ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në mbrojtjen dhe zhvillimin e vendit, ndaj për ne ju do të mbeten pikë referimi”, – mbylli fjalën e tij ministri i Mbrojtjes Piro Vengu.

Ndërsa në fjalën e tij ish-komandanti i “SHMU Skënderbej” Mikail Vaso, mes lumturisë që ndodhej sërish mes ish-kolegëve, pedagogëve dhe ish-studentëve të tij, solli në kujtesë vitet e vështira dhe plot sfida të ushtarakëve në ato vite të vështira.

“Shkolla ‘Skënderbej’ është një shkollë e veçantë që ka ushqyer me qindra breza me parime të forta, ajo është simbol i shpresës për një të ardhme të sigurt. Ne iu jemi mirënjohës brezave për përkushtimin dhe devotshmërinë e tyre në këtë rrugëtim të



“80 Vjet Dritë dhe Lavdi: Trashëgimia e Shkollës ‘Skënderbej’ në Zemrën e Kombit”



vështirë, sfidues por të pakrahasueshëm me asnjë tjetër profesion”, – mbylli fjalën e tij ish-komandant Vaso.

Gjithashtu, një moment emocionues ishte takimi mes gjeneratave të ndryshme të skënderbegasve, të cilët ndanë kujtime dhe përvoja nga jeta e tyre ushtarake. Ky 80-vjetor shërben jo vetëm për të festuar të kaluarën e lavdishme të shkollës “Skënderbej”, por edhe për të projektuar të ardhmen e saj, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të arsimit ushtarak në Shqipëri. Brezat e rinj do të vazhdojnë të frymëzohen nga trashëgimia e kësaj shkolle dhe të përgatiten për të qenë mbrojtës të denjë të atdheut.

Në përfundim, në emër të ministrit të Mbrojtjes, Pirro Vengu u shpërndanë certifikata mirënjohje për disa prej të pranishmeve. Kjo ceremoni nuk është thjesht një jubile, por një dëshmi e fortë e rolit të pazëvendësueshëm që ka pasur dhe do të ketë shkolla “Skënderbej” në historinë e ushtrisë shqiptare dhe të kombit tonë.

Sot, me respekt dhe dashuri, ata njëzëri i drejtohen kësaj shkolle me fjalët: Faleminderit, e dashur shkollë “Skënderbej”! Faleminderit për disiplinën që mësove, për vlerat dhe rrugën që ndriçove për kaq shumë të rinj!



Prej disa ditësh në komandën e Forcës Detare u zhvillua “Aktiviteti Sportiv i Shahut”, ndërmjet ekipeve përfaqësuese të Komandës së FT, FD, FAJ, AFA, KMS, SHP, PU, BMSHPFA, QPR, dhe ASNI.

Forca Detare u shpall fituese në të gjitha tavolinat e Kampionatit të Shahut në Forcat e Armatosura, ndërsa Rreshter Xhezahir Elezi u kurorëzua kampion individual.

Në kuadër të këtij eventi dhe 100-vjetorit të Forcave Detare, Llambi Pasku, 8 herë kampion i Shqipërisë, Mjeshtër i Madh dhe fitues i shumë turneve ndërkombëtare, zhvilloi një simultane shahu, duke promovuar këtë sport dhe frymën e konkurrencës në



radhët e ushtarakëve.

Ky kampionat shënoi një arritje të rëndësishme për Forcën Detare dhe një hap përpara në forcimin e bashkëpunimit dhe promovimin e sportit në FARSH.



Komandanti i KM, gjeneral brigade Aleksandër Pando merr pjesë në Konferencën e 11-të të Xhenios në Varshavë

Nga data 24 deri më 28 mars, ekipi i Komandës Mbështetëse, i kryesuar nga gjeneral brigade Aleksandër Pando, mori pjesë në Konferencën e 11-të të Xhenios dhe Logjistikës në Varshavë. Ky event mbledhi përfaqësues ushtarakë dhe kompani të fushës për të diskutuar zhvillimet më të fundit teknologjike dhe operacionale. Ekipi shqiptar prezantoi temën “Modernizimi i kapaciteteve xheniere dhe EOD të FARSH”, duke ndarë eksperiencat dhe vizionin për përmirësimin e kapaciteteve ushtarake. Një mundësi e vlefshme për shkëmbim njohurish, forcim bashkëpunimesh dhe eksplorim të inovacioneve ushtarake.



Efektivët e togës së kërkim-shpëtimit në Detashmentin e Mbështetjes Rajonale, Mengel, në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve operacionale dhe ruajtjes së gatishmërisë për ndërhyrje të shpejtë dhe profesionale në raste emergjencash civile, realizuan një stërvitje intensive në stacionin e alpinizmit.



Trajnim i përbashkët i efektivëve të Forcës Ajrore, trupave komando dhe ekipit amerikan SATMO, në kuadër të rritjes së aftësive të personelit fluturues për operacione në zona urbane. Përdorimi i helikopterit UH-60, në këtë trajnim është pjesë e modernizimit të kapaciteteve tona ushtarake, duke testuar gatishmërinë operacionale dhe forcuar ndërveprimin mes njësisë tokësore dhe ajrore.



Efektivët e anijes Butrinti të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, pjesë e misionit të NATO-s “Sea Guardian” në Detin Egje, zhvilluan një stërvitje të përbashkët me anijen gjermane FGS “Planet A1437”. Gjatë stërvitjes në ujërat ndërkombëtare, u testuan aftësitë operacionale dhe u zhvilluan skenarë për rritjen e jetëgjatësisë së anijes, përfshirë menaxhimin e emergjencave si përmbytja dhe zjarri në bord. Gjithashtu, u ekzekutuan procedurat e parabordimit dhe bordimit ndaj një mjeti detar, si dhe u realizua një simulim i dhënies së ndihmës së shpejtë në anije, duke forcuar bashkëpunimin dhe ndërveprimin mes forcave pjesëmarrëse.



80 vite përkushtim, sakrificë dhe lavdi – Shkolla ‘Skënderbej’, tempulli i formimit të brezave ushtarakë

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Shkolla “Skënderbej”, tempulli i dijes së njerëzve me vlera të veçanta

Në jetën e çdo njeriu ka vende që lënë gjurmë të pashlyeshme, që formojnë karakterin dhe përcaktojnë rrugën e tij në jetë. Për shumë ushtarakë shqiptarë, një nga këto vende është padyshim shkolla ushtarake “Skënderbej”. Ajo nuk është thjesht një institucion arsimor, por një tempull edukimi, disipline dhe atdhedashurie.

Që nga momenti i parë kur një i ri hyn në këtë shkollë, ai kupton se jeta nuk do të jetë më e njëjtë. Uniforma që vishet me krenari nuk është vetëm një veshje, por një simbol përgjegjësie dhe nderi. Çdo hap i hedhur në oborrin e shkollës është një hap drejt përgatitjes për të qenë një shërbëtor besnik i atdheut.

Një vend ku rritesh si njeri dhe si ushtarak

Shkolla “Skënderbej” nuk është vetëm një vend ku mësohen disiplinat ushtarake dhe shkencore, por një shtëpi e dytë ku ndërtohen vlera të forta si disiplina, ndershmëria, përkushtimi dhe besnikëria ndaj kombit. Mësuesit dhe instruktorët nuk janë thjesht pedagogë, por udhërrëfyes që frymëzojnë dhe edukojnë breza të tërë.

Në këtë shkollë, çdo ditë është një sfidë, por edhe një mundësi për të mësuar dhe për t’u forcuar. Orët e gjata të stërvitjes, studimi i përkushtuar dhe jeta e rregullt nuk janë vetëm përgatitje fizike dhe intelektuale, por një mësim i madh për jetën. Kjo shkollë mëson se suksesi nuk vjen lehtë, por kërkon punë të palodhur dhe një zemër të fortë.

Një trashëgimi e lavdishme

Historia e shkollës “Skënderbej” është historia e vetë ushtrisë shqiptare. Brezat që kanë dalë nga ky institucion kanë shërbyer me nder dhe kanë dhënë kontributin e tyre për mbrojtjen dhe zhvillimin e vendit. Ata janë shembulli i një edukimi cilësor, të bazuar në patriotizëm dhe profesionalizëm.

Sot, kur shkolla feston 80-vjetorin e saj, ata që dikur ishin djem dhe vajza të reja, sot janë burra dhe gra me karriera të suksesshme, por kurrë nuk e harrojnë vendin ku u formuan. Për ta, shkolla “Skënderbej” nuk është vetëm një etapë e jetës, por një pjesë e pandashme e shpirtit të tyre.

Ndërsa brezat ndryshojnë dhe koha ecën përpara, një gjë mbetet e sigurt: shkolla “Skënderbej” do të vazhdojë të jetë një simbol i krenarisë kombëtare dhe një vatër e ndritur e edukimit ushtarak. Në zemrat e të gjithë atyre që kanë kaluar nëpër korridoret e saj, ajo do të mbetet përgjithmonë një shtëpi e shenjtëruar nga përkushtimi, sakrifica dhe dashuria për atdheun.

Në çdo shoqëri, ka njerëz që dallohen për përkushtimin, disiplinën dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësisë. Ata janë individë që kanë mësuar të sakrifikojnë për një qëllim më të madh dhe të veprojnë gjithmonë me ndershmëri e përkushtim. Një kategori e veçantë e këtyre njerëzve janë ish-nxënësit e shkollës ushtarake “Skënderbej”, të cilët kanë formuar karakterin e tyre në një mjedis ku rregulli dhe disiplina ishin bazat e çdo veprimi.

Bashkëjetesa me një ish-skënderbegas më ka krijuar këto ndjesi të bukura për këta njerëz të veçantë të shoqërisë shqiptare.

Shkolla “Skënderbej” nuk është një institucion i zakonshëm arsimor. Ajo është një vend ku disiplina nuk është thjesht një rregull për t’u ndjekur, por një mënyrë jetese.

Brezat e nxënësve që kanë dalë prej saj kanë mësuar vlerën e përpikërisë, respektit dhe punës së palodhur. Që nga momenti kur kanë veshur për herë të parë uniformën, ata janë mësuar të jenë të përgjegjshëm, të vendosur dhe të gatshëm për të përballuar çdo sfidë.

Në një botë ku shumë njerëz kërkojnë rrugën më të lehtë, ish-nxënësit e kësaj shkolle kanë zgjedhur një rrugë të vështirë, por të nderuar. Ata janë mësuar të respektojnë rregullat, të bashkëpunojnë në grup dhe të veprojnë gjithmonë me ndershmëri. Këto cilësi nuk mbeten vetëm brenda shkollës, por e shoqërojnë çdo individ gjatë gjithë



jetës, duke i bërë ata shembuj të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit.

Ish-nxënësit e shkollës “Skënderbej” janë shpërndarë në fusha të ndryshme të jetës, duke dhënë kontributin e tyre, jo vetëm në Forcat e Armatosura, por edhe në institucione shtetërore, akademi, drejtësi dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm. Disiplina dhe përgatitja që kanë marrë në shkollë i ka bërë ata liderë të përgjegjshëm dhe qytetarë të ndershëm. Në ushtri, ata kanë mbrojtur me dinjitet atdheun, duke u shndërruar në simbole të besnikërisë dhe profesionalizmit. Në institucione të tjera, ata kanë treguar integritet dhe përkushtim, duke dhënë një shembull për gjithë shoqërinë.

Njohja dhe vlerësimi i ish-nxënësve të shkollës “Skënderbej” nuk është vetëm një akt mirënjohjeje, por edhe një mënyrë për të frymëzuar brezat e rinj. Në një kohë kur shumë të rinj kërkojnë modele suksesi, këta individë janë shembulli më i mirë se si puna, disiplina dhe përkushtimi të çojnë drejt suksesit të vërtetë.

Përkushtimi i tyre ndaj rregullit dhe disiplinës nuk duhet të mbetet në hije, por duhet të vlerësohet dhe promovohet si një model për gjithë shoqërinë. Respekti ndaj këtyre njerëzve nuk është vetëm një detyrim moral, por edhe një nxitje për të tjerët që të ndjekin shembullin e tyre.

Historia e shkollës “Skënderbej” dhe e ish-nxënësve të saj është një pjesë e rëndësishme e historisë së Shqipërisë. Brezat e rinj duhet të mësojnë nga këta njerëz dhe të ndjekin rrugën e disiplinës dhe ndershmërisë. Për këtë arsye, është e rëndësishme që shoqëria t’i njohë dhe t’i vlerësojë ata si burra dhe gra të përkushtuar ndaj kombit dhe detyrës.

Ish-nxënësit e shkollës “Skënderbej” nuk janë thjesht individë që kanë kaluar nëpër një institucion ushtarak. Ata

janë njerëz që kanë marrë me vete një filozofi jete, një ndjenjë të fortë përgjegjësie dhe një përkushtim të palëkundur ndaj vlerave më të larta të shoqërisë. Për këtë arsye, ata meritojnë respekt, vlerësim dhe njohje nga të gjithë.

Çdo brez ka nevojë për modele dhe figura që shërbejnë si udhërrëfyes në rrugën e jetës. Në Shqipëri, një nga grupet që ka mishëruar më së miri vlerat e disiplinës, përkushtimit dhe ndershmërisë janë ushtarakët paraardhës. Ata kanë dëshmuar me veprat e tyre se si sakrifica, disiplina dhe dashuria për atdheun ndërtojnë një shoqëri të fortë dhe të qëndrueshme.

Disiplina dhe Përkushtimi – Vlera të Rralla

Ushtarakët e brezave të kaluar kanë dëshmuar se disiplina është çelësi i suksesit. Ajo i ndihmon individët të përballojnë sfidat, të marrin vendime të drejta dhe të jenë të përgatitur për çdo situatë. Në një kohë kur ritmi i jetës po ndryshon dhe shumë të rinj kërkojnë rrugë të lehta, mësimet e ushtarakëve të dikurshëm janë më të vlefshme se kurrë.

Atdhedashuria dhe Ndjenja e Përgjegjësisë

Brezi i ri duhet të mësojë nga paraardhësit se shërbimi ndaj atdheut nuk është vetëm një detyrë, por një nder. Ushtarakët shqiptarë kanë dëshmuar me veprat e tyre se mbrojtja e kombit kërkon sakrifica dhe përkushtim të palëkundur. Ata janë modeli më i mirë për t’i treguar të rinjve se dashuria për vendin shprehet jo vetëm me fjalë, por me veprime dhe përkushtim të vazhdueshëm.

Integriteti dhe Ndershmëria – Shembuj për të Rinjtë

Në një shoqëri që përballlet me sfida të ndryshme morale dhe etike, brezat e ardhshëm mund të marrin frymëzim nga ndershmëria dhe integriteti i ushtarakëve të kaluar. Ata kanë treguar se të jesh i drejtë dhe i ndershëm nuk është vetëm një zgjedhje personale, por një domosdoshmëri për të ndërtuar një shoqëri të qëndrueshme dhe të drejtë.

Frymëzimi për Brezat e Rinj – Pse Duhet të Vazhdojmë Traditën?

Nëse të rinjtë sot ndjekin shembullin e paraardhësve të tyre ushtarakë, ata do të jenë më të përgatitur për sfidat e jetës. Do të jenë më të disiplinuar, më të përgjegjshëm dhe më të aftë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për veten dhe shoqërinë.

Brezi i ri duhet të shohë ushtarakët e kaluar si udhërrëfyes dhe burim frymëzimi. Vlerat që ata kanë përcjellë, disiplina, përkushtimi, atdhedashuria dhe ndershmëria, janë të papërsëritshme dhe të domosdoshme për ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Duke ndjekur këtë shembull, të rinjtë do të jenë në gjendje të krijojnë një të ardhme më të ndritur për veten dhe për kombin.



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Strategji, Siguri dhe Lidership: Një Bisedë Ekskluzive me Përfaqësuesin Ushtarak Kombëtar në ACO SHAPE, gjeneralmajor Petrit Çuni

Gjeneralmajor Petrit Çuni lindi, më 6 shtator 1969, në Shkodër. Ai nisi karrierën e tij ushtarake në vitin 1984, në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Pas përfundimit të studimeve në vitin 1988, ai vazhdoi edukimin në Akademinë e Forcave Tokësore “Skënderbej”, në Tiranë, ku u diplomua në vitin 1992. Gjeneral Çuni ka një karrierë të gjerë ushtarake, duke shërbyer si në pozicione shtabi ashtu edhe në ato komanduese. Pas diplomimit, ai mori detyrën si Zëvendëskomandant Kompanie në Batalionin e Tankeve në B. Curri. Në vitin 1993, u emërua Komandant i Batalionit të Tankeve, dhe më pas ka vazhduar shërbimin në njësitë e tankeve deri në korrik 2003.

Në vitin 2003, emërohet Shef i Operacioneve dhe Stërvitjes të blk në Brigadën e Reagimit të Shpejtë (BrRSh). Brenda pak muajsh, ai u ngrit në detyrë si Zëvendëskomandant i blk të BrRSH. Në këtë periudhë, gjeneral Çuni ka qenë Komandant i Kontingjentit Shqiptar të Paqeruajtësve në Bosnje dhe Hercegovinë, duke marrë pjesë në 2 misione të NATO-s, SFOR dhe EUFOR, në vitet 2004 dhe 2006. Këto misione i mundësuan të fitonte përvojë të gjerë në operacionet ndërkombëtare dhe të bashkëpunonte me forcat e tjera të NATO-s.

Përveç eksperiencës operacionale, zhvillimi profesional i gjeneral Çunit ka vazhduar me ndjekjen e arsimimit si brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 1997, ai ndoqi Kursin e Komandantit të Batalioni në Shkollën e Tankeve në Munster, Gjermani. Më vonë ai ndoqi studimet e avancuara ushtarake në Gjermani, duke ndjekur Akademinë e Drejtimit të Bundeswehr-it, në Hamburg, ku u diplomua në qershor 2009. Pas përfundimit të studimeve, po në të njëjtën Akademi në vitin 2009, ka përfunduar Kursin për Sigurinë Europiane. Zhvillimi i tij profesional vazhdoi me kurse të ndryshme të lidershipit dhe metodologjisë, duke përfshirë Programin për Studime të Avancuara të Sigurisë në Qendrën “George C. Marshall” në vitin 2010, Kursin Orientues për Oficerin e Shtabit të NATO-s në vitin 2015 dhe Kursin e politikave për oficerët e lartë në vitin 2021 në shkollën e NATO-s, Gjermani.

Gjeneral Çuni ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në arsimin dhe zhvillimin profesional të oficerëve shqiptarë. Në vitin 2009, ai u emërua Zëvendëskomandant i Universitetit Ushtarak “Skënderbej”, përpara se të bëhej Komandant i këtij institucioni, në vitin 2011. Në këtë detyrë, ai punoi për modernizimin e kurrikulave ushtarake dhe përafrimin e tyre me standardet e NATO-s. Më pas, ai shërbeu si Pedagog Përgjegjës i Kursit të Lartë të Oficerit në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Në vitin 2013, gjeneral Çuni mori një detyrë të rëndësishme ndërkombëtare si Përfaqësues Kombëtar në Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s (JFC) në Brunssum, Holandë, ku punoi për tre vjet, duke përfaqësuar Shqipërinë në strukturat strategjike të Aleancës. Pas kthimit në Shqipëri, ai u emërua Drejtor i Drejtorisë së Politikave NATO, BE dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes. Më pas u caktua Shef i Shtabit të Forcës Tokësore, ku fill pas një viti do të emërohej Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Prej vitit 2019, gjeneralmajor Petrit Çuni është Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar i Shqipërisë në Komandën Strategjike të NATO-s (ACO SHAPE) në Belgjikë, duke përfaqësuar interesat e vendit në strukturat më të larta të Aleancës. Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në vitin 2021 ai u gradua ‘gjeneral brigade’, ndërsa në shkurt të vitit 2025, u promovua në gradën ‘gjeneralmajor’.



Gjatë karrierës së tij të gjatë dhe të suksesshme, gjeneralmajor Çuni është nderuar me disa dekorata kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjeneralmajor Petrit Çuni, përmes kësaj interviste vjen për shtypin ushtarak dhe jo vetëm, për të sjellë në vëmendje rëndësinë e këtij institucioni dhe misionin, të cilin, prej korrikut të vitit 2019, vazhdon ta përmbushë me sukses, profesionalizëm dhe devotshmëri të lartë.

I nderuar Gjeneral!

Cili është roli dhe misioni kryesor i Përfaqësuesit Ushtarak Kombëtar (PUK) në ACO SHAPE?

Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar (PUK) është figura qendrore e përfaqësimit të Shqipërisë në NATO, në nivel ushtarak operacional dhe strategjik. Ky pozicion ka një rëndësi të veçantë pasi përfaqëson Shqipërinë në Komandën Operacionale të Aleancës (ACO), një nga dy komandat strategjike të NATO-s, që merret me planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve të Aleancës.

Misioni kryesor i PUK është të sigurojë që interesat kombëtare mbrohen, Shqipëria dhe FARSH përfaqësohen dhe të promovohen në mënyrën më të mirë të mundshme kudo dhe kurdoherë dhe më konkretisht në diskutimet, vendim-marrjet në tavolinën me 32 anëtarë të NATO-s.

Kjo arrihet përmes: Pjesëmarrjes aktive në forume ushtarake, takime dhe vendimmarrje në ACO SHAPE, gjithashtu në koordinim me PURSH në NATO, Bruksel, siguron që Shqipëria të ketë zërin e saj në politikat dhe strategjitë ushtarake të Aleancës; Koordinimit dhe ndërlidhjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe ACO, SHAPE; Mbështetjes

së personelit shqiptar të emëruar në ACO dhe menaxhimit të çështjeve administrative dhe financiare të tyre; Sigurimit të informacionit të përditësuar për autoritetet shqiptare mbi zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes brenda NATO-s, gjithashtu edhe zhvillimeve në Zonën e Përgjegjësisë (AOR) se aleancës.

Në një kuadër më të gjerë, PUK luan një rol të rëndësishëm në forcimin e pozitës së Shqipërisë si një aleate e denjë, pro aktive e NATO-s, duke ofruar dhe evidentuar kontributin e Shqipërisë dhe FARSH-së në mbrojtjen kolektive të Aleancës.

Si ndikon PUK në marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n në aspektin ushtarak dhe strategjik?

PUK është hallka kryesore e komunikimit ndërmjet Shqipërisë dhe ACO në aspektin ushtarak dhe strategjik. Roli i tij është parësor për të siguruar që politika e mbrojtjes dhe angazhimi ushtarak i Shqipërisë të jenë në harmonizim me prioritetet e NATO-s, duke patur në fokus interesat kombëtare dhe forcimin e pozicionit të vendit si një partner i besueshëm i Aleancës.

Disa nga drejtimet kryesore përmes të cilave PUK ndikon në marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n janë:

Mbajtja e vazhdueshme e komunikimit me homologët (PUK të vendeve aleate) e vendeve anëtare të NATO-s, nëpërmjet ndërtimit të një marrëdhënie besimi dhe ndërveprimi reciproke, në mënyrë që t'i shërbejë sa më mirë shkëmbimit të përvojave, eksperiencës dhe interesave të përbashkëta;

Angazhimi në planifikimin strategjik të NATO-s – PUK siguron që prioritetet e sigurisë kombëtare të Shqipërisë të integrohen në dokumentet dhe planet strategjike të Aleancës;

Koordinimi i stërvitjeve dhe operacioneve – Shqipëria / FARSH është e angazhuar në misione të NATO-s si KFOR në Kosovë, operacionet detare në Detin Egje, forcave të përparuara (FLF) në kufijtë lindorë të Aleancës etj.;

Ndikimi në vendimmarrjet e NATO-s – PUK siguron që përfaqësuesit e Shqipërisë në NATO të kenë akses në informacionin e nevojshëm dhe që pozicioni i Shqipërisë të jetë i qartë në çështjet kyçe të sigurisë dhe mbrojtjes.

Si përfaqësohen interesat e Shqipërisë brenda strukturave të NATO-s përmes jush?

PUK përfaqëson Shqipërinë në të gjitha forumet ushtarake të ACO SHAPE, ku diskutohen dhe miratohen vendimet për operacionet dhe strategjitë e Aleancës. Kjo përfshin: Pjesëmarrjen në takime dhe konferenca të nivelit strategjik të NATO-s, ku PUK prezanton, mbron qëndrimet dhe angazhimet e Shqipërisë në këtë nivel; Negocimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit (MoU), Marrëveshje teknike (TA), Notave të Aderimit (NoJ), të cilat lidhen me praninë e Shqipërisë në NATO dhe kontributin e saj në operacionet e Aleancës;

Komunikimin me DPPM, SHPFA, AISM dhe Forcat për të përcjellë materiale, informacione dhe dokumente mbi zhvillimet dhe përditësimet e herë pas hershme të NATO-s, të cilat mund të kërkojnë pasqyrim dhe reflektim në dokumentet strategjike dhe planet tona kombëtare;

Përfaqësia Ushtarake Kombëtare siguron që qëndrimi i Shqipërisë të gjejë reflektim në dokumente dhe vendim-marrje në nivel operacional-strategjik.

Në cilat linja kryesore veprimi operon PUK për të përmbushur misionin e tij?

PUK operon në katër linja kryesore:

- Përfaqësimi
- Koordinimi dhe Ndërlidhja
- Ekspertiza dhe Këshillimi
- Elementi Mbështetës Kombëtar

Këto linja veprimi përbëjnë katër shtyllat kryesore të veprimtarisë së PUK gjatë përmbushjes së misionit.

Si funksionon koordinimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe komandave të NATO-s?

Për sa i përket pjesës së parë të pyetjes, koordinimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, theksoj se procesi i komandim-kontrollit dhe koordinimi është i mirë përcaktuar në dy dokumente të miratuara, si Rregullorja për Atashetë Ushtarakë dhe Përfaqësuesit Ushtarakë dhe civilë të MM së RSH, si dhe në Procedurën Standarde të Veprimit (PSV) të Përfaqësisë Ushtarake Kombëtare në ACO, SHAPE dhe strukturat e vartësisë.

Çfarë roli ka PUK në menaxhimin e angazhimeve të Shqipërisë në operacionet dhe misionet e NATO-s?

Zyra e PUK ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e operacioneve dhe angazhimeve të Shqipërisë në NATO. Është pika hyrëse e dokumenteve, kërkesave, informacioneve që Komanda e ACO, SHAPE u drejton vendeve anëtare; Bën vlerësimin e tyre dhe i adreson ato në DPPM dhe SHPFA me rekomandimet dhe opsionet e mundshme; Bën menaxhimin dhe koordinimin e personelit shqiptar në misionet dhe operacionet e NATO-s dhe BE; Bën ndjekjen e gjendjes së trupave shqiptare në terren, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit shqiptarë (SNR) në operacione për të siguruar mbështetjen e nevojshme; Gjithashtu bën raportimin dhe analizimin e sfidave dhe mësimeve të nxjerra nga misionet, për të përmirësuar më tej pjesëmarrjen dhe performancën e angazhimeve në misionet dhe operacionet e ardhshme.

Sairëndësishëm është komunikimi dhe bashkëpunimi me përfaqësuesit e tjerë ushtarakë të vendeve anëtare?

Komunikimi dhe bashkëpunimi me përfaqësuesit e tjerë ushtarakë të vendeve anëtare të NATO-s është jetik për një përfaqësim efektiv të Shqipërisë brenda Aleancës. Kjo përfshin: Krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit me homologët nga vendet e tjera të NATO-s, për të ndarë informacione dhe praktika më të mira mbi çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, koordinimin e qëndrimeve strategjike mbi çështje kyçe të sigurisë, për të siguruar që Shqipëria të jetë pjesë e diskutimeve dhe vendimarrjeve të rëndësishme të NATO-s, pjesëmarrjen aktive në takime dhe forume ndërkombëtare, ku përcaktohen prioritetet dhe planet e NATO-s për operacionet dhe mbrojtjen kolektive, si dhe forcimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet aleate, për të zgjeruar mundësitë e bashkëpunimit ushtarak, përfshirë stërvitjet e përbashkëta, projektet e mbrojtjes dhe asistencën teknike.

Cilat janë sfidat kryesore që përballeni në përmbushjen e detyrave tuaja si PUK?

Disa nga sfidat kryesore që PUK përballët përfshijnë përshtatjen me mjedisin e sigurisë në ndryshim të vazhdueshëm, duke iu referuar zhvillimeve të fundit gjeopolitike dhe sfidave me të cilat përballët arkitektura e sigurisë botërore, siç është agresioni i pajustificuar rus në Ukrainë, terrorizmi ndërkombëtar dhe kërcënimet hibride. Sfidë tjetër janë kërkesat në rritje për reagim të shpejtë dhe të sinkronizuar ndaj sfidave të sigurisë në Zonën e Përgjegjësisë së NATO-s, të cilat në të njëjtën kohë përkthehen në burime njerëzore, materiale dhe teknikë të

gatshme dhe të certifikuara.

Thënë këto, pavarësisht nga sfidat që përballemi në punën e përditshme, me bashkëpunim me autoritetet vendim-marrëse në MM dhe SHPFA, jemi përgjigjur në kohë dhe me angazhime konkrete ndaj kërkesave të ACO.

Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në NATO dhe çfarë përmirësimesh mund të bëhen në nivel strategjik?

Për të ilustruar pjesën e parë të pyetjes Tuaj, më lejon i të huazoj një thënie të ish-Sekretarit të Mbrojtjes të SHBA-ve, Jim Mattisi, i cili gjatë vizitës zyrtare të Ministrit të Mbrojtjes së Shqipërisë në SHBA, ka deklaruar:

“Shqipëria ka treguar se madhësia gjeografike ka shumë më pak rëndësi se angazhimi në Aleancë. Si një aleate e vendosur, Shqipëria godet më fort se sa pesha e saj”.

Thënia e tij thotë shumë, dhe është ikonike për Shqipërinë dhe FARSH-në, duke dashur t'i shtoj kësaj edhe faktin që sot, Shqipëria përfaqësohet në të gjitha NCS dhe NFS, duke plotësuar në masën 100 % angazhimin e saj me personel në këto struktura (Një nga vendet e pakta).

Për pjesën e dytë se çfarë përmirësimesh mund të bëhen në nivel strategjik, mund t’iu referohem dokumenteve strategjike të miratuar së fundmi nga Parlamenti i Shqipërisë dhe Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura të RSH 2024-2033. Mjafton t’u përmbahemi dhe të jetësojmë kërkesat dhe prioritetet e këtyre dokumenteve, në këtë mënyrë kemi bërë të mundur arritjen e objektivave në nivel taktik, operacional dhe strategjik.

A ka ndonjë strategji të re për të forcuar përfaqësimin dhe ndikimin e Shqipërisë në strukturat ushtarake të NATO-s?

Punën e vazhdueshme të Ministrisë së mbrojtjes dhe SHPFA për të forcuar përfaqësimin e Shqipërisë në strukturat ushtarake të NATO-s, e tregon më së miri numri i lartë i personelit ushtarak në struktura dhe operacione të NATO-s, të cilët kanë marrë vlerësime maksimale nga NATO për punën dhe profesionalizmin e tyre. Në dijeninë time DPPM në MM dhe SHPFA janë në proces vlerësimi, rishikimi të pozicioneve aktuale dhe atyre të mundshme që Shqipëria mund të marrë në të ardhmen.

Çfarë mundësish ofron NATO për trajnimin dhe zhvillimin profesional të personelit ushtarak shqiptar?

NATO ofron një gamë të gjerë mundësish për trajnimin dhe zhvillimin profesional të personelit ushtarak shqiptar, duke siguruar që ata të jenë të përgatitur sipas standardeve më të larta të Aleancës. Këto mundësi përfshijnë:

1. Kurse dhe Akademi Ushtarake të NATO-s

Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s (NATO Defense College - NDC, Romë, Itali) – Ky institucion prestigjioz ofron kurse strategjike për oficerë të lartë, duke përfshirë tematika si menaxhimi i krizave, lidershipi dhe operacionet e NATO-s.

Shkolla e NATO-s në Oberammergau, Gjermani – Ofron trajnime mbi politikën e mbrojtjes, strategjinë ushtarake dhe operacionet e NATO-s.

2. Trajnime në kuadër të Forcave të Reagimit të Aleancës (ARF - Allied Response Force)

Oficerët dhe ushtarakët shqiptarë marrin pjesë në stërvitje të përbashkëta me vendet aleate, duke përmirësuar aftësitë e tyre në operacione të përbashkëta ushtarake.

Këto trajnime përqendrohen në fusha të tilla si luftimi urban, mbrojtja kibernetike dhe operacionet speciale.

3. Programe për Lidershpin dhe Menaxhimin Ushtarak

Këto programe sigurohen nëpërmjet bashkëpunimeve dypalëshe me Akademitë respektive. Kursi për Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s – Siguron trajnime për oficerët që do të shërbejnë në pozicione të larta strategjike.

4. Mbështetje për trajnimet në Shqipëri

Baza Ajrore e Kuçovës, si një bazë taktike e NATO-s, në të ardhmen mund të shërbejë për të zhvilluar trajnime të avancuara për pilotët dhe personelin teknik shqiptar, nëpërmjet Grupeve të Trajnimit të Lëvizshme (Mobile Training Team).

Shqipëria gjithashtu organizon stërvitje të përbashkëta në poligonin kombëtar të Bizës, duke trajnuar forcat speciale dhe njësitë e këmbësorisë sipas standardeve të NATO-s.

5. Programet e Trajnimit për Luftën Kibernetike dhe Mbrojtjen nga Kërcënimet e Reja

NATO ka rritur fokusin në mbrojtjen kibernetike, dhe

oficerët shqiptarë janë përfshirë në programe trajnimi për identifikimin dhe neutralizimin e kërcënimeve kibernetike. Shqipëria është pjesë e qendrave të ekselencës të NATO-s, për sigurinë kibernetike dhe luftën hibride.

Nëpërmjet këtyre programeve, personeli ushtarak shqiptar rrit aftësitë e tij profesionale dhe teknike, duke siguruar që Shqipëria të kontribuojë në mënyrë më efektive në operacionet e NATO-s.

Si po kontribuon Shqipëria në objektivat e NATO-s për mbrojtjen kolektive dhe sigurinë ndërkombëtare?

Siç e kam theksuar edhe në përgjigjet e dhëna më sipër, Shqipëria kontribuon në mënyrë mjaft domethënëse në NATO dhe për këtë ka marrë vlerësime maksimale. Për t’i dhënë një përgjigje pak më të detajuar pyetjes, po listoj disa nga angazhimet aktuale që Shqipëria jep në kuadër të mbrojtjes kolektive dhe sigurisë ndërkombëtare:

1. Pjesëmarrja në Operacionet e NATO-s

Misioni KFOR në Kosovë – Trupat shqiptare kanë ndihmuar në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

Pjesëmarrja në Letoni dhe Bullgari në kuadër të FLF – Shqipëria ka dërguar trupa për të forcuar mbrojtjen e krahut lindor të NATO-s.

Operacioni detar i NATO-s në Detin Egje – Njësitë detare shqiptare janë angazhuar në patrullime për të mbështetur përpjekjet kundër trafikimit të paligjshëm dhe kërcënimeve detare.

Misioni “NATO Mission Irak” – Shqipëria ka dërguar personel, të cilët luajnë rolin e këshilluesit për autoritetet e Irakut.

Misioni “ALTHEA” në Bosnje Hercegovinë – Shqipëria ka dërguar trupa në mbështetje të misionit të BE.

Pjesëmarrja në Komandën e NATO-s, për Ndihmë dhe Trajnim për Ukrainën “NSATU”.

Pjesëmarrja në misionin “INTERFLEX”, UK.

2. Rritja e Buxhetit të Mbrojtjes dhe Modernizimi i Forcave të Armatosura

Shqipëria ka arritur 2% të PBB-së për mbrojtjen, duke përmbushur objektivin e NATO-s për shpenzimet ushtarake.

Investime në teknologjinë ushtarake – Shqipëria ka blerë dronë të avancuar “Bayraktar TB2” për të përmirësuar aftësitë e mbikëqyrjes dhe mbrojtjes.

Modernizimi i Forcave Ajrore dhe Tokësore – Vendosja e bazës ajrore të NATO-s në Kuçovë dhe pajisja e forcave tokësore me mjete të reja luftarake ka rritur ndjeshëm kapacitetet operacionale të FARSH.

3. Mbështetja për Partnerët e NATO-s dhe Sigurinë Rajonale

Shqipëria ka mbështetur fuqishëm Ukrainën në luftën e saj kundër agresionit rus, duke ofruar ndihmë ushtarake dhe humanitare.

Angazhimi në iniciativat rajonale të sigurisë – Shqipëria merr pjesë në nisma të NATO-s për Ballkanin Perëndimor, duke promovuar stabilitetin në rajon, si dhe është një zë i fuqishëm mbështetës për Republikën e Kosovës dhe rrugën e saj drejt aderimit në këto iniciativa rajonale, në Programin e NATO-s të Partneritetit për Paqe (PfP) dhe në organizmat e BE-së.

Si faktor kryesor stabiliteti në rajonin e Ballkanit, Shqipëria vazhdon të luajë këtë rol, duke promovuar iniciativa në funksion të paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit midis vendeve të rajonit, siç ishte dhe nënshkrimi i Deklaratës së Përbashkët të Ministrave të Mbrojtjes së Shqipërisë, Kosovës dhe Kroacisë, e firmosur më 18 mars në Tiranë.

4. Sigurimi i Infrastrukturës Strategjike të NATO-s

Baza Ajrore e Kuçovës, tashmë realitet, është një projekt i rëndësishëm që e vendos Shqipërinë në hartën strategjike të NATO-s. Kjo bazë do të shërbejë si një bazë taktike dhe operacionale për Aleancën.

Projekti në zhvillim i Porto Romano-s, si pjesë integrale e Korridorit të VIII që lidh Detin Adriatik me Detin e Zi, i është ofruar tashmë NATO-s për t’u përdorur si infrastrukturë portuale për mbështetjen e operacioneve detare dhe njëherësh si një korridor strategjik i lëvizjes, për afrimin e shpejtë të trupave në zonën e përgjegjësisë së KFOR-it dhe në drejtimin jug-lindor.

Projekti i zhvillimit dhe modernizimit të bazës detare të Pashalimanit, si një bazë detare e përfshirë në Listën e Përzgjedhjes së Infrastrukturës Detare (MFSL) nga MARCOM.

Rrugëtimi 80 – vjeçar i legjendës ‘Fidanishtja Skënderbej’

Rrugëtimi i Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”

Më 28 mars 1945, në Tiranë u hap “Shkolla e Pionierëve të Luftës”, ku nxënësit e parë ishin 200 partizanë të vegjël midis tyre edhe 6 vajza. Në vitet që pasuan numri i nxënësve do të rritej ndjeshëm.

Në shkurt 1947, me urdhër të Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura, Nr. A 1-85, datë 11 shkurt 1947, shkolla e pionierëve të luftës mori emrin Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Shkolla e nisi veprimtarinë në garnizonin ushtarak të Laprakës, më pas u vendos tek Regjimenti i Ndërlidhjes e së fundmi u vendos tek kompleksi i shkollave ushtarake. Deri në vitin 1953 skënderbegasit morën arsim 7-vjeçar, disa klasë të mesme dhe njohuri ushtarake.

Në vitin 1953 u vendos që shkolla “Skënderbej” të bëhej shkollë plotësisht e mesme e arsimit të përgjithshëm, duke përfshirë në të edhe lëndë të karakterit ushtarak. Shkolla kishte program 4-vjeçar të gërshetuar me fushime dimërore e verore 15-30 ditë për çdo vit.

Misioni i Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” ishte të përgatiste nxënës me arsim të mesëm ushtarak të përgjithshëm dhe me formim të nevojshëm për ndjekjen e shkollave të larta civile dhe ushtarake, për t’u përgatitur si oficerë të aftë të Forcave të Armatosura.

Nga viti 1960 gati 60% e studentëve të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve vinin nga Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Në vitin 1992 Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej” u mbyll.

Akademia Ushtarake “Skënderbej”

Shkolla “Skënderbej”, që nga viti i parë i krijimit të saj e deri në mbyllje, me Vendimin e Këshillit të Mbrojtjes Nr. 3, datë 17.8.1992, ishte furnizuesja kryesore e Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, Akademisë Ajrore dhe asaj të detarisë...

Akademia Ushtarake “Skënderbej” u krijua më 8 nëntor 1944, si një kurs i ulët për përgatitjen e kuadrove e oficerëve. Në janar të vitit 1945, u vendos në Tiranë. Më 8 janar të vitit 1949, ajo mori emrin Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve “Enver Hoxha”. Për herë të parë në këtë shkollë në vitin mësimor 1967-1968 u pranuan femrat, qindra prej të cilave e kanë mbaruar me sukses atë.

Shkollën e Bashkuar e kanë drejtuar gjeneralë e komandantë të shquar si Vaskë Gjino, Gjin Marku, Thoma Xhixho, Qazim Kapisyzi, Enver Begeja, Halil Xhuka, Spiro Adhami, Rustem Peci, Aleks Andoni, Perlat Sula, Armand Vinçani, Luan Hoxha etj. Mijëra ushtarakë kanë studiuar në këtë shkollë, ndërkohë që dhjetëra prej tyre kanë arritur të drejojnë strukturat më të larta ushtarake dhe të marrin gradën Gjeneral. Në vitin 1993 kjo shkollë mori emrin Akademia Ushtarake “Skënderbej”. Ka qenë vatra kryesore e përgatitjes së oficerëve për ushtrinë shqiptare.

Përveçse kujtimeve të dëshmitarëve të kohës në dhjetëra dekada, historia e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, është e dokumentuar dhe në arkivat e kohës, përkatësisht në Arkivin Qendror të Shtetit, arkivat e Ministrisë së Mbrojtjes, të Muzeut të Ushtrisë si dhe mund të lexojmë e rilexojmë mijëra faqe të tjera nga libra të shkruar nga skënderbegas apo shkrime e kronika të kohës në medie (gazeta, arkivat filmike të Televizionit Shtetëror, arkivin e filmit të Ushtrisë).

Nxënësit e parë të shkollës “Skënderbej”

Mes 200 nxënësve të parë të kësaj shkolle ishin dhe 6 vajza partizane, ndër to, Katerina Priifti, Xhevahire Golemi e Veronika Murzaku...

Komandant i parë i Shkollës së Pionierëve (më vonë u emërua Shkolla e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”), u vendos Thoma Frashëri.

Ndër kuadrot e parë të kësaj shkolle ishin Dule Pashai (drejtor), komandant Isuf Bobaj si dhe kuadrot e mësuesit Kadri Mullai, Shuaip Laze, Filip Stefani, Miço Kola, Pavlina Grabocka, Selman Tafa, Hamdi Cani, Kadrie Kopliku, Arqile Kondi, Thoma Frashëri, Luto Haxhiu, Stavri Angjeli, Bajram Shamku, Fiqiri Shtepani, Sotir Polena...

Më 10 Korrik 1945, ditën e krijimit të ushtrisë, kuadratet e skënderbegasve parakaluan në bulevardin e Tiranës për herë të parë para Enver Hoxhës e udhëheqësve, duke u duartrokatur nga qytetarët. Në shkurt të vitit 1947, shkolla e pionierëve, me Dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, mori emrin Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”.

Në fillim të vitit 1948, komisar i shkollës u emërua Koço Lako, ndërsa drejtor i saj Stavri Angjeli. Në fund të vitit 1948, komandant i shkollës emërohet Ferit Radovicka, ndërsa komisar emërohet Bedri Gjergji. Në vitin shkollor 1949-1950, rritet numri i skënderbegasve, dhe shkolla transferohet në Laprakë.

Fillimi i vitit mësimor 1951-1952 u bë në Vlorë

Në Olimpiadën Teatrale të zhvilluar në vitin 1954, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, mori Fletë Lavdërimi nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.

Në verën e vitit 1956, shkolla mori pjesë në aksionin për shpyllëzimin e kodrave të Zall Herrit.

Në shtator të vitit 1959, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, zhvendoset në kazermat e Regjimentit



të Ndërlidhjes.

Në gusht të vitit 1966, për një muaj rresht, nxënësit e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, bënë aksion në Bizë për të mbledhur humus për tokat e reja dhe në Tapizë të Tiranës për shpyllëzim e hapjen e tokave të reja.

Në shtator të vitit 1966, drejtor i shkollës emërohet Fiqri Shtëpani. Në nëntor të vitit 1966, në festimet për nder të 28-29 nëntorit, ditës së pavarësisë dhe çlirimit, efektiv i shkollës “Skënderbej” manifestoi kalimin me not dhe pajime të liqenit artificial, në prani të Enver Hoxhës e udhëheqësve të tjerë të vendit.

Në qershor të vitit 1967, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, kreu aksionin e njohur në ndihmë të bujqësisë (prashitje misri e korrije gruri) në Zall Herr.

Në maj të vitit 1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor i RPSH i dha shkollës Urdhrin “Naim Frashëri” të klasit III për rezultate të larta të qëndrueshme sportive.

Në qershor të vitit 1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, dekoron organizatën e rinisë së shkollës me Urdhrin “Për shërbime të shquara ushtarake dhe shoqërore të Klasit III”, me motivacionin: “Është dalluar për rezultate të larta në përgatitjen politike-ushtarake, në forcimin e vigjilencës e të disiplinës dhe të rregullit ushtarak, për punë edukative me rininë në marrjen e iniciativave të reja për revolucionarizimin e stërvitjes dhe për ta bërë ushtrinë sa më pak të kushtueshme”.

Në vitin shkollor 1967-1968, kontingjente të maturantëve të shkollës, vijuan studimet e larta në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin Fizkulturës “Vojo Kushi”.

Në gusht të vitit 1968, matura e skënderbegasve mori pjesë në aksionin kombëtar për hapjen e rrugës në Malësinë e Madhe. Për këtë punë të shkëlqyer në aksion, më 23 qershor të vitit 1968, Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë, dekoron organizatën e BRPSH të Shkollës “Skënderbej” me Urdhrin e Punës së Klasit të Parë, me motivacion: “Ka manifestuar një frymë të lartë gatishmërie për të kapërcyer pengesat. Ka punuar në frontet më të vështira dhe ka arritur rezultate të larta në punë, duke u bërë shembull për mijëra vullnetarë që merrnin pjesë në ndërtimin e rrugës së Malësisë së Madhe. Ka qenë shembull në organizimin e një pune të vazhdueshme ideopolitike duke e kthyer aksionin në një vatër të madhe për edukimin komunist të rinisë”.

Në fillim të vitit shkollor 1971-1972, (muaj shtator) shkolla “Skënderbej” kreu aksionin për tarracimin e kodrave të Ksamilit në Sarandë.

Nga 21 tetori 1972 deri më 4 nëntor, shkolla kreu aksionin për korjen e misrit në Çermë të Lushnjës. Në shtator të vitit 1973, vitet e II, III, IV të shkollës “Skënderbej” ishin në aksion për ndërtimin e hekurudhës Elbasan-Përrenjas, përkatësisht në sektorin e Hotolishtit. Puna e një muaji, u krye në 20 ditë.

Më datë 28 shkurt, të vitit 1974, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë, i dha organizatës së rinisë së Shkollës Ushtarake “Skënderbej” Urdhrin e Punës së Klasit I me motivacionin: “Ka organizuar dhe ka drejtuar mirë punën për edukimin politik dhe ideologjik të rinisë. Ka arritur rezultate shumë të mira në punë për ndërtimin e hekurudhës Elbasan-Përrenjas, duke u bërë shembull për organizatën e rinisë. Ka zhvilluar aktivitete të gjithanshme, duke e kthyer aksionin në një vatër të madhe për edukimin klasor e revolucionar të rinisë”.

Në shtator të vitit 1975, shkolla “Skënderbej”, (viti i tretë), mori pjesë në aksionin për ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik

“Çeliku i Partisë” në Elbasan, përkatësisht në ndërtimin e TEC-it në këtë vepër.

Pas diplomimit në maturë (matura 1976-1977), një grup nga shkolla “Skënderbej” dërgohen për të ndjekur studimet në degën e kufirit në Shkollën e Ministrisë së Brendshme.

Matura e vitit 1977, stazhin e prodhimit (një vit) e kanë kryer në ndërtimin e hidrocentralit “Drita e Partisë” në Fierzë. Edhe maturantët skënderbegas të vitit pasardhës, stazhin në prodhim e kryen po në ndërtimin e hidrocentralit “Drita e Partisë” në Fierzë. Në këtë vepër energjetike, si pasojë e aksidentit në punë, humbi jetën tragjikisht skënderbegasi Arben Kiteni, i Elektro-Mekanikes, dega radio...

Në vitin 1978, skënderbegasit e vitit të tretë kryen një muaj aksion për fortifikimin, në Ballenjë të Matit e Shupenzë të Dibrës.

Skënderbegasit maturantë të vitit mësimor 1978-1979, stazhin e prodhimit (1979-1980) e kryen tre muaj në hidrocentralin “Enver Hoxha” të Komanit dhe 6 muaj të tjerë në hekurudhën Laç-Shkodër, përkatësisht në sektorin e Mjedës.

Viti mësimor 1980-1981 regjistron 1083 skënderbegas që ndjekin këtë shkollë në të gjitha degët e saj.

Në muajin qershor të vitit 1981, skënderbegasit e vitit mësimor 1980-1981, zhvilluan aksionin në Cepo të Gjirokastrës për hapjen e rrugës së re automobilistike dhe në Patos për hapjen e kanaleve.

Matura e vitit 1980, punën prodhuese njëvjeçare (viti mësimor 1980-1981) e kreu në Ksamil të Sarandës.

Në qershor të vitit 1982, skënderbegasit e vitit të tretë bënë aksion për fortifikimin e vendit në Mal të Kuq të rrethit të Korçës dhe në Cerencë të Pogradecit.

Skënderbegasit e vitit mësimor 1982-1983 (vitet e treta), kryen aksion njëmuor në ndihmë të bujqësisë në Rrëshen të Mirditës dhe në Brar të Tiranës.

Skënderbegasit e viteve të dyta e të treta, në qershor të vitit 1984, u krye aksioni në tarracat me agrume në Sasej (Bunec) të Lukovës.

Më 28 mars 1985, në ditën e 40-vjetorit të shkollës, krahas aktiviteteve të shumta, u shfaq dhe premiera e dokumentarit të Kinostudios “Shqipëria e Re” të titulluar “Fidanishtja e Ushtrisë Popullore”.

Maturantët e vitit 1985, punën prodhuese e kryen në uzinat ushtarake të Tiranës. Në janar të vitit 1986, skënderbegasit shkuan për fushim dimëror në Voskopojë të Korçës. Në muajin qershor të vitit 1986, skënderbegasit e vitit të tretë kryen një muaj aksion në ndihmë të bujqësisë në Grabian të Lushnjës.

Në qershor të vitit 1988, skënderbegasit e vitit të tretë punuan një muaj për ndërtimin e hekurudhës Milot-Rrëshen-Klos, përkatësisht në sektorët Shkjezë, Tarazh dhe Prosek.

Në qershor të vitit 1989, skënderbegasit morën pjesë në aksionin për mbledhjen e bimëve medicinale në Qafëmallë dhe Feken të Tiranës.

15 nëntor 1993, në zbatim të një dekreti të veçantë të Presidentit Sali Berisha, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes Safet Zhulali, mbyllet Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”.

Që nga krijimi i saj, më 28 mars 1945, deri në mbyllje, më 15 nëntor 1993, në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” kanë studiuar mbi 35 mijë vetë.

Historia e asaj shkolle është një fill i pashkëputur mësimi, edukimi e formimi kulturor, atdhetar dhe ushtarak, është vepra më e arrirë e atij sistemi që lamë pas. Kjo shkollë do të mbetet gur themeli në historinë e Shqipërisë.

Në vitin 1992, me urdhër të qeverisë së kohës, ky institucion i rëndësishëm i përgatitjes fillestare të kuadrove ushtarakë të Forcave të Armatosura e arsimit në Shqipëri, mbylli dyert.

Shkolla Ushtarake “Skënderbej” i dha ushtrisë modelin e ushtarakut të aftë e të përkushtuar, me formim demokratik dhe për rrjedhim, në transformimet e viteve 1990-1991, spikati bindshëm figura e oficerit qytetar të emancipuar dhe patriot.

Për shkollën “Skënderbej” dhe skënderbegasit janë shkruar dhe do të shkruhen shumë, pasi, ajo ishte dhe mbetet një nga shkollat më të mira të vendit dhe një vatër e rëndësishme, ku nisin udhën e përgatitjes kuadrot e ardhshëm të ushtrisë shqiptare, duke zënë një vend të rëndësishëm në historinë e arsimit e mbrojtjes së vendit. Dhe jo vetëm kaq. Nxënësit që përzgjidheshin për të studiuar në këtë shkollë mbi kritere specifike (djemtë më të mirë), ndër vite e dekada, kanë çarë me dinjitet rrugët e jetës, duke u bërë personalitete të fuqishme të vendit në shumë fusha, që nga letrat, diplomacia, arti, shkenca, pushteti, deputetë, ministra e presidentë. Janë me dhjetëra e qindra skënderbegas që kanë lënë e po lenë gjurmë evidente në këto fusha të rëndësishme dhe në sektorë delikatë e prioritar të vendit. Si të tillë, këto personalitete ish-skënderbegas, kanë merituar e meritojnë nderim e respekt tek shqiptarët.

Historia e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” është pjesë e rëndësishme e historisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Kjo është një e vërtetë e padiskutueshme, e vlerësuar tashmë historikisht me dokumente, punën e gjallë dhe rezultatet konkrete.

Çdo fushë e prodhimit material e shpirtëror të shoqërisë, si dhe çdo strukturë në fushën ushtarake përfaqësohet me personalitete të rangjeve të ndryshme, duke formuar plejadën e strategëve, të reformatorëve dhe gjeneralëve. Këtu nuk mund të lihet pa përmendur edhe organizatori, kompozitori dhe dirigjenti i muzikës, i këngës ushtarake shqiptare dhe i valleve popullore, gjenerali i Ansamblit të Ushtrisë Shqiptare dhe Kombëtare, Gaqo Avrazi.

Një formacion gjigand, kompleks dhe luftarak, siç ishte Ansambli i Ushtrisë, u lind e u lartësua me emrin, autoritetin dhe kontributet e tij të veçanta.

Që kur ishte 15 vjeç, Gaqo Avrazi u bë i njohur në veprimtaritë artistike të qytetit të tij. Ai ëndërronte të studionte në një shkollë jashtë vendit, por ambicia e tij dilte jashtë mundësive ekonomike, ndaj i duhej të radhitej mes punëtorëve të artizanatit korçar, ku mes tyre do të gjente edhe këngën. Shoqëritë “Agroni” e “Rinia korçare”, si dhe një orkestër që ngriti mësuesi i parë i tij, kompozitori Kristo Kono, i mundësuan atij njohjen e teorisë së muzikës. Kështu nisën këngët e para si “Mulliri”, “Për Mëmëdhenë”, “Marsejeza” etj., melodi patriotike që, për t’iu ruajtur censurës, mësoheshin në shtëpitë përdhese, pas mureve të larta ose bodrumeve të thella dhe shfaqeshin në veprimtaritë antifashiste. Për këtë arsye, në vitin 1941, Gaqo Avrazi u burgos. Këtu filloi edhe lidhja e tij me lëvizjen mbarë popullore antifashiste. Pasi hyri në radhët partizane u thirr nga udhëheqës të luftës e të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së për t’iu përveshur ngritjes së një “Brigade Sulmuese Shpirtërore”, për të frymëzuar me atdhetari e shpirt luftarak brigadat e vërteta luftarake. Kështu, këngëtari, kompozitori dhe dirigjenti diletant, plot pasion e talent të rrallë, ngriti korin e parë të ushtrisë antifashiste (Mokërr, në vitin 1943). Kori përfaqësonte trupën e parë artistike të ushtrisë, mbi të cilën do të rritej Ansambli i ardhshëm i Ushtrisë, për të shkuar nga 31 partizanë e partizane në rreth 300 artistë të punësuar, të aktivizuar pas çlirimit.

Gaqo Avrazi, themeloi grupin e parë artistik partizan të Qarkut të Korçës dhe të të gjithë Shqipërisë, me anën e të cilit përhapi këngët mëmëdhetare, partizane dhe revolucionare të traditës si dhe këngët e kompozitores Dhora Leka.

Ai drejtoi korin e UNÇSH-së, që u krijua më 25 korrik 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Pas vitit 1945, mbi bazën e këtij kori, u krijua Ansambli Artistik i Ushtrisë, të cilin e drejtoi për shumë vjet me mjeshtëri.

Gaqo Avrazi krijoi shumë poema, kantata, muzikë dhome, këngë, marshe, tablo muzikore. Ishte drejtues artistik i talentuar e me kulturë të gjerë profesionale, i cili kujtohet me mall dhe mirënjohje edhe sot nga ish-koristet e kompanisë së vajzave (1967-69).

MIRKA BOZO XHEBRAJ

Mirëmëngjesi, një ditë e mbarë dhe e qetë! Çfarë të të them?? Më kujtohen koncertet dhe, në mënyrë të veçantë provat që bëheshin përpara shfaqjeve.

Në atë numër të madh koristësh e koristesh, dirigjenti Gaqo Avrazi tregonte shpirtin e tij artistik, profesional dhe njerëzor. Në veçanti, dinte të komunikonte me të gjithë tipat e koristëve. Vizionin me të cilin zotëronte platenë, skenën dhe ÇDO tingull të gabuar që mund të dëgjohej. Reagonte në mënyrë të menjëhershme dhe energjike, edhe PSE ishte në moshë relativisht të madhe prag-pensiononi. Tek ai shihej dirigjenti i qeshur dhe xhentil, që nuk nervozohet lehtë. Nuk di ç’të them tjetër!

QAMILE

Po them edhe unë një kujtim. Gaqo Avrazi i dirigjonte provat i hipur mbi dy tavolina të bashkuara, ku ishte vendosur një karrige, në shpinën e së cilës ishin varur disa peshqirë. Një peshqir e mbante rreth qafës dhe e ndërronte shpesh, ndërsa nga mesi e lart ishte lakuriq vazhdimisht i mbuluar nga djersët, që i fshinte me peshqirët rezervë. Një moment na dha pushim.

Mbasi mbaroi pushim, ne filluam të hynim brenda sallës së kinemasë së shkollës ku bëheshin provat. Tek dera rrinte ushtari-roje. Para meje ndodhej Pandi Peleshi, këngëtari solist: - Hape derën! - i tha ushtarit. Ai pa ia hapur derën, i ktheu përgjigji:

- Nuk të njoh!
- Hape se jam Pandi Peleshi!
Kushdo qofsh, nuk ta hap se nuk të njoh!

FLORA

Edhe unë do them një moment: Kuptohet duhet të ishim në kohën e duhur në prova, Gaqo ishte shumë strikt, ndonëse ishte i rreptë gjatë provave, ishte edhe gazmor.

LIDA

Në këtë Koncert dy këngë kënduam ne, vajzat kursante të kompanisë së vajzave:
Ikën shoqet, ikën,
Malit se ç’më vanë,
Ikën e s’më pritën,
Rrëmbyen dogranë!
Je e vogël, i thanë
Nuk bën për dogranë

Gjenerali i Ansamblit të Ushtrisë Shqiptare dhe Kombëtare Gaqo Avrazi dhe ne, koristet kursante



Dale moj, më merrni
Në mal e në çetë
Juve të më therrni
Po s’u bësh me fletë!
Pandi Peleshi e përgatiti grupin tonë të vajzave të Shkollës së bashkuar për këtë këngë: “Ikën shoqet ikën”, e mbaj mend mirë.
Këngë tjetër ishte:
Po rritet kalliri në buzë të transhesë,
dhe kënga në shpatmali buçet.
Gëzohet ushtari fytyra i qesh,
Se korr sot prodhimin e vet.
Refreni:
Shqipe mali jemi ndër beteja,
gishtin në këmbëz gati,
tarraca hapim dhe toka të reja
gjer atje thellë, thellë në kufi!
Repartin më pak të kushtueshëm ta bëjmë,
se vetë gjithçka e prodhojmë,
Kjo fjalë e partisë si diell ndriçon



na fion ne, të gjithëve në aksion.
Refreni: Shqipe mali jeni ndër beteja ... etj.
ZEMRA
Nuk më kujtohet mirë.
Njëra nga këngët që këndonim kish këto vargje:
...Po rritet kalliri në buzë të trashesë
.....
Gëzohet ushtari fytyra i qesh
Ishin këngë që ne do t’i këndonim shpesh me hap, këngë rreshtore, edhe nëpër mjediset e shkollës, por edhe kur shkonim për stërvitje jashtë në terrene të ndryshme, rrugëve të Tiranës veriore kur shkonim i këndonim.

BOÇI

Ato që shkroi Qamilja më kujtohen edhe mua. Gaqo, ndjesë pastë, djersitej shumë dhe mbante peshqirin në qafë, duke u fshirë. Kur patëm koncertin në stadium, ishim rreshtuar bukur, ne vajzat me uniformën tonë të gjelbër, kurse djemtë ishin kombinuar me veshjen e gjelbër dhe atë marinari të bardhë, si edhe në paradë.

Kori i madh më mahniste me zërat, i kujtoj përherë. Ishte një këngë, mezi po më kujtohen vargjet:

Mes krismave, rrufe dhe vetëtimave,
u linde ti, në luftën për liri,
partia jonë, ti o parti e trimave ... me timonier etj.

LULE CANKJA

Me thanë të drejtën ishte i paparë!!! Ai hidhesh me gjithë forcën e tij dhe i vëmendshëm tek zëri i koristit që të ishte pa asnjë gabim!! Kur mbaronim dhe dilnim jashtë sallës së provave që ishte Salla e kinemasë, komentonim se sa lodhej dhe sa me shpirt punonte!!! Këtë e kam në mendje, i paharruar qoftë!

Ju si jeni Lili? !!! Përqafime dhe Përrshëndetje të gjitha shoqeve!!
Koriste, banon në SHBA

LILIANA MERO

Për mua ishte e mahnitshme, për atë, se si e bëri të mundur që në një kohë rekord, të arrinte sukses të merituar me një shumicë qindra koristësh të arrinte t’i harmonizonte së bashku 800 djem e vajza, në një konglomerat të vërtetë. Pjesëmarrësit ishin nga kori i Operës dhe Baletit, Ansambli Popullor i Këngëve dhe Valleve dhe të tjerët, shumica dërrmuese e atij kori 800 vetash, skënderbegas, nxënës të shkollës së mesme ushtarake dhe studentë të shkollës së bashkuar të oficerëve “Enver Hoxha”. Këta ushtarakë, shumica kishin kënduar si nxënës nëpër shkolla. Dhe e magjishmja ishte se gjithë ata të rinj që vinin nga veriu i Shqipërisë, në pjesën më të madhe vinin nga një traditë e të kënduarit me një zë, nën shoqërimin ose jo të një çiftelie e lahute klasën e tyre, pra një person a ndoshta edhe dy. Por edhe ata që vinin nga jugu i Shqipërisë, në traditat e tyre njihej e kënduara me polifoni, ku katër-pesë vetë ishin koristë e po aq ata që mbanin iso.

Të jesh grua do të thotë të sfidosh çdo kufi, të ëndërrosh pa frikë dhe të ndërtosh me duart e tua atë që dikur dukej e pamundur

Gratë Ushtarake: Forca, Sfidat dhe Barazia në Forcat e Armatosura

Gratë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe në ushtritë e tjera të botës kanë dëshmuar se janë të afta të përballojnë sfida të shumta, duke balancuar jetën ushtarake me rolet e tyre si nëna, bashkëshorte dhe si gra. Pavarësisht natyrës tradicionale mashkullore të ushtrisë, gratë ushtarake kanë arritur të thyejnë barrierat dhe të integrohen në të gjitha nivelet e shërbimit ushtarak.

Forca dhe Përkushtimi i Grave në Ushtri

Gratë ushtarake i nënshtrohen të njëjtave standarde stërvitore dhe disiplinore si kolegët e tyre burra, duke dëshmuar aftësi të larta në fushën e betejës, operacionet logjistike dhe drejtimin strategjik.

Shumë gra në Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë arritur gradat më të larta, duke marrë role drejtuese në komandat ushtarake dhe në misione ndërkombëtare.

Gratë shqiptare kanë marrë pjesë aktivisht në misionet paqeruajtëse të NATO-s dhe OKB-së, duke dëshmuar profesionalizëm dhe përkushtim.

Sfidat që përballin gratë ushtarake

Gratë ushtarake përballen me një sërë sfidash unike që lidhen me natyrën e profesionit të tyre, dhe shpesh herë këto sfida janë të dyfishta, duke përfshirë presionin për të realizuar standardet ushtarake dhe për të përballuar pritshmëritë shoqërore për rolin e grave në ushtri.

Përpjekja për të provuar veten

Gratë ushtarake shpesh ndihen të detyruara të punojnë më shumë dhe të tregojnë aftësitë e tyre për të fituar respektin e kolegëve dhe të komandantëve meshkuj, të cilët mund të kenë paragjykime për aftësitë e grave në këtë fushë. Pritshmëritë për ta mund të jenë më të larta, për shkak të stereotipeve që mund të ekzistojnë në lidhje me aftësinë e gruas për të përballuar detyrat ushtarake.

Balancimi i jetës familjare dhe karrierës ushtarake

Një nga sfidat më të mëdha për gratë ushtarake është balancimi i kërkesave të punës me jetën familjare. Shërbimi ushtarak kërkon angazhim të plotë dhe mund të përfshijë orar të jashtëzakonshëm, shpesh larg shtëpisë. Gratë që janë gjithashtu nëna ose bashkëshorte duhet të përpiqen të menaxhojnë këto përgjegjësi dhe të kujdesen për familjen pa sakrifikuar karrierën e tyre.

Përballimi i diskriminimit dhe paragjyqimeve

Edhe pse ka patur përparime në drejtim të barazisë gjinore, gratë në ushtri shpesh mund të përballen me paragjykime dhe diskriminim, si nga kolegët meshkuj ashtu edhe nga struktura e komandës. Pritshmëritë sociale dhe profesionale mund të krijojnë barrierat që ndalojnë gratë të avancojnë në pozita të larta drejtuese. Pjesa më e madhe e grupeve ushtarake janë ende të dominuara nga meshkujt, dhe kjo mund të krijojë një ambient ku gratë ndihen të nënvlerësuara ose të pavlerësuara.

Trajnimi dhe përshtatja me standardet ushtarake

Për gratë, të cilat mund të mos kenë aftësitë fizike të natyrshme të meshkujve, mund të jetë më e vështirë të arrijnë disa standarde fizike dhe ushtarake. Kjo mund të krijojë një pengesë për gratë që dëshirojnë të avancojnë në karrierën ushtarake ose të marrin pjesë në misione të rrezikshme. Megjithatë, shumë gra i përballojnë këto sfida përmes angazhimit dhe përpjekjeve të jashtëzakonshme për të përmirësuar shëndetin dhe aftësitë e tyre fizike.

Kultura e ushtrisë dhe stereotipat gjinore

Edhe pse ka pasur përparime në drejtim të barazisë gjinore, ushtria shpesh ka një kulturë të theksuar mashkullore, ku çështjet si konkurrenca fizike, ndihma me shokët dhe marrëdhëniet miqësore mund të krijojnë sfida për gratë që mund të ndihen të përjashtuara ose të mos ndihmojnë sa duhet në integrimin social. Ky mentalitet mund të ndikojë në ndjenjën e përkatësisë dhe mund të jetë një pengesë për gratë që kërkojnë të arrijnë pozita të larta.

Përvoja të ndryshme nga meshkujt në zonat e luftës

Gratë ushtarake mund të përballen me vështirësi të tjera në misionet e luftës, duke përfshirë sfida fizike dhe psikologjike që mund të jenë ndryshe nga ato të meshkujve. Ato gjithashtu mund të përballen me frikën e mundshme të sulmeve seksuale ose ngacmimeve nga kolegët, për shkak të natyrës të ndryshme të seksit dhe identitetit gjinor në zonat e luftës.

Ndihma dhe mbështetja nga institucionet

Në disa raste, gratë mund të ndihen të paafta të kërkojnë mbështetje ose ndihmë për shkak të frikës nga stigmatizimi. Mungesa e programeve të mbështetjes psikologjike dhe strategjive për barazi gjinore mund të bëjë që gratë të ndihen të vetmuara



ose të pa përkrahura.

Gratë ushtarake janë një pjesë thelbësore e forcave të armatosura, dhe pavarësisht nga sfidat e shumta që ato përballojnë, ato vazhdojnë të tregojnë guxim dhe përkushtim. Sfida kryesore është krijimi i një ambienti më të barabartë dhe mbështetës, ku gratë të kenë mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre dhe për të kontribuar me aftësitë e tyre në forcën ushtarake. Kjo përpjekje është një proces që kërkon angazhim, por ka potencialin për të sjellë një ushtri më të fortë dhe më të bashkuar.

A Ndihen Gratë të Diskriminuara?

Në vitet e fundit, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë marrë hapa konkretë për të promovuar barazinë gjinore dhe për të siguruar që gratë ushtarake të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Janë krijuar struktura që mbikëqyrin dhe mbështesin gratë në ushtri, duke siguruar që të kenë të njëjtat mundësi për ngritje në detyrë. Promovimi i grave në pozicione drejtuese, ka një numër gjithnjë e më të madh të grave që mbajnë pozicione kyçe në komandat ushtarake, duke u dhënë mundësi të barabarta për të udhëhequr. Ndryshimi i kulturës ushtarake: nëpërmjet trajnimeve dhe sensibilizimit, janë reduktuar paragjykimet tradicionale dhe është krijuar një ambient më përfshirës për gratë në ushtri.

Gratë ushtarake në Shqipëri dhe kudo në botë kanë treguar se janë të forta, të afta dhe të përkushtuara për të përballuar sfidat e



jetës profesionale dhe personale.

Ndonëse ende mund të ketë sfida, përparimet në barazinë gjinore, ndryshimet në kulturën ushtarake dhe politikat mbështetëse kanë krijuar një mjedis ku gratë mund të shërbejnë me dinjitet dhe të kenë sukses në karrierën e tyre ushtarake.

Forcat e Armatosura po punojnë për të siguruar që gratë ushtarake të kenë mundësi të barabarta dhe të ndihen të vlerësuara, pa ndjenjën e diskriminimit. Ndryshimi i mentalitetit dhe promovimi i një kulture gjithëpërfshirëse janë hapa kyç drejt një ushtrie moderne dhe të fortë.

Të jesh grua në uniformë është një përgjegjësi e madhe, një sfidë dhe një nder. Kërkon guxim, disiplinë dhe përkushtim të palëkundur, jo vetëm për të përmbushur detyrat ushtarake, por edhe për të balancuar rolet e shumta në jetë.

Një grua në uniformë është një simbol force dhe sakrifice, një shembull i barazisë dhe përkushtimit ndaj kombit. Ajo përballlet me sfida të dyfishta, jo vetëm për të përmbushur standardet e profesionit të saj, por edhe për të thyer barrierat dhe për të dëshmuar aftësitë e saj në një fushë ku dikur dominonin meshkujt. Pavarësisht vështirësive, vendosmëria për të qëndruar, për të luftuar dhe për të ecur përpara është ajo që e bën një grua ushtarake të jashtëzakonshme.

Ti nuk je vetëm pjesë e një force ushtarake, je pjesë e një ndryshimi dhe një inspirimi për të gjithë!

Administratore e Shkollës “Skënderbej”, Arta Reveli, Shefe e Administratës Arsimore në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”, është një prej portreteve që do kujtohet me dashuri prej disa brezash, nxënësish dhe studentësh të kësaj shkolle. Ishin fillim vitet 1991-1992, në kohën kur segmente të errëta (përfshi dhe struktura të shtetit), krahas shkatërrimeve të tjera, iu vërsulën arkivave, Arta Reveli do të sakrifikonte jo pak, duke marrë e ruajtur dokumentet e shkollës “Skënderbej” në shtëpi, shumë nga ato sot nuk do të ishin në arkivat e shtetit, duke u mohuar brezave memorien kombëtare. Bëhet fjalë për atë kohë të trazuar, kur drejtuesi i shtetit ato vite, as më pak e as më shumë, do ta quante Shkollën e lavdishme Ushtarake “Skënderbej”, “Shkollë jeniçerësh”. Kur situata u qetësua e shteti nisi të marrë ‘frymë’, këto dokumente u dorëzuan (me proces-verbal të rregullt) nga Arta në Arkivin Qendror të Ushtrisë, ku ndodhen edhe sot. Ndonëse kanë kaluar vite dhe moshë bën të vetën, ashtu si atëherë, elegante, simpatike dhe me një gatishmëri e memorie të veçantë, është një pjesë shumë e rëndësishme e jetës së saj në këtë institucion, për të cilën ajo krenohet dhe flet me respekt e nostalgji.

“Vite të gjata pune në Shkollën Ushtarake ‘Skënderbej’. Mësues dhe drejtues të shkollës ‘Skënderbej’ vështirë të ndërtohen sot, më mbajnë gjallë, më rinojnë... Shkolla Ushtarake ‘Skënderbej’ nuk kishte e ende nuk ka një të dytë në Shqipëri... Unë kam filluar punë në Shkollën Ushtarake ‘Skënderbej’ në vitin 1976 dhe jam larguar që andej kur ajo, me urdhër të veçantë (viti 1992), u mbyll. Para se të emërohesha në këtë shkollë në detyrën e Shefes së Administratës Arsimore, unë kisha punuar 6-7 muaj në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Përveçse shkollimit, që ishte i domosdoshëm për këtë funksion, unë kisha përfunduar dhe 2 vite shkollim për arkiviste. Kujtoj se atë kohë, kjo shkollë kishte bërë një emër të mirë jo vetëm për trupën pedagogjike, atë të komandimit e drejtimit, nivelin e lartë të mësimdhënies e përvetësimit, por dhe për administrim perfekt, që fillonte me rregull e disiplinë, me orar që nga zgjimi, deri në mbylljen e aktivitetit ditor. Në vitin 1966 kur unë nisa punë në këtë shkollë, drejtor gjeta Stavri Angjelin, i cili u zëvendësua pas pak kohe nga Fiqiri Shtëpani. Komandant shkolle ishte Luto Haxhija, ndërsa Islam Poçi ishte shef shtabi. Kam pasur fatin të punoj me shumë personalitete të fushës së arsimit ku unë mund të përmend Irakli Kasnecin, Gjylizare Çicon, trupën mësimdhënëse të shkollës, Flutura Xoxen, Hamide Dajën, Pavli Bicin, Sami Bogdanin, Shpëtim Bozdon, Ali Nevirin, Petraq Ikonomin, Llazar Mbreshtanakun, etj...

Njëkohësisht, krahas trupës komanduese e mësimdhënëse, një kontribut të rëndësishëm kanë dhënë dhe punonjësit civilë të sektorëve ndihmës, ku ndër të tjera unë po përmend Bedrije Dukën e Murat Petrelën, të dy rrobaqepës; Gaço Ogrenin e Reshit Muçën këpucar; sanitaren Sabrije Fitezi, bashkëshortët Mahmut e Meriban Parllaku, që të dy kuzhinierë; Polikseni Qiricin, Qirjako Killapin, Naum Priftin, Zhaneta Kratin, të katërt kuzhinierë etj...

Në këtë shkollë, unë kam pasur të bëj direkt dhe me nëpunësit e personelit, ku dua të veçoj Liri Xhaxhiun, Reshat Mukën e deri tek i fundit, Adem Hamitin... Kjo shkollë, ishte nga më cilësoret dhe kishte një përkujdesje të veçantë shtetërore, përkatësisht nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Arsimit. Një urdhër i veçantë i shtetit të kohës, në funksion të zgjedhjes së mësuesve më të mirë dhe afrimin e tyre në këtë shkollë, lejonte që të zgjidheshin mësuesit më të mirë kudo që ishin dhe të afroheshin në shkollën “Skënderbej” pa asnjë pengesë”, - shprehet znj. Arta për botimin historik “Skënderbegasit ndër vite”.

“Faksimile të historikut të shkollës ushtarake ‘Skënderbej’, pas studimeve e vrojtimeve, me përfaqësues të tjerë të shkollës, kam vajtur në Seksionin e Arsimit dhe Komitetin Ekzekutiv të Tiranës për të tërhequr dosjet e personave mësimdhënës që merrnim në shkollë. Kjo praktikë, ndiqej jo vetëm në Tiranë, por dhe në rrethet e tjera të vendit. Kështu, janë tërhequr për të dhënë mësim në këtë shkollë dhe mësues të njohur nga Durrësi, Korça, Elbasani, Gjirokastra, Gramshi e shumë rrethe të tjera të Shqipërisë. Për shkak të punës specifike që kisha, marrëdhëniet e mia i shin kryesisht me drejtuesit e shkollës, me gjithë mësuesit, por edhe me organizatat shoqërore, pasi çdo gjë e aktivitet dokumentohej në sektorin që unë drejtoja. Ndërkohë, në historikun e shkollës “Skënderbej”, krahas mësimdhënies, procesit mësimor dhe edukimit ushtarak, një vend të rëndësishëm zinin dhe aksionet e ndryshme në shkallë kombëtare e ato lokale.

Në shumë vepra dhe objekte të rëndësishme të kohës, është dhe munda e djersa e skënderbegasve, si në fushën e mbrojtjes, në bujqësi, në industri e aspektin social e shoqëror. Kështu, brigadat e skënderbegasve ishin në pararojë në ndërtimin e hekurudhave, në tarracimin e kodrave, në ndërtimin e veprave energjetike etj... Po ashtu, falë punës që bëhej në këtë institucion, përfaqësuesit e skënderbegasve pothuaj vazhdimisht renditeshin në vendet e para në konkurset e dijeve midis shkollave të mesme të Tiranës dhe në shkallë vendi. Kurse çdo vit, skënderbegasit shkonin një muaj për pushimet verore në Karpen, ku planëzoheshin dhe organizoheshin aktivitete të shumta kulturore e sportive. Ajo që e ngriti shkollën ‘Skënderbej’ në atë emër që kishte, që e ruan edhe sot, ishte organizimi i përsosur, bashkëpunimi efektiv dhe angazhimi i gjithë administratës, trupës pedagogjike e mësimore, komanduesve e vetë skënderbegasve, në funksion të rritjes së nivelit të përvetësimit të

ARTA REVELI, “ARKIVA” E GJALLË E SHKOLLËS “SKËNDERBEJ”



dijeve. Për këtë, jo vetëm studimet kishin orare fikse e ndiqeshin nga mësuesit, por aplikoheshin edhe punë suplementare dhe e diferencuar. Në funksion të saj, në periudha të caktuara, pas mësimit, grupe mësuesish drekonin në shkollë (për të cilën merreshin të gjitha masat) dhe pasdite ishin me skënderbegasit nëpër klasa në orët e studimit. Me të drejtë, Shkolla Ushtarake ‘Skënderbej’ është cilësuar si ‘fidanishte e ushtrisë’. Është fakt që janë me qindra nxënësit e kësaj shkolle që në udhët e jetës, janë integruar me dinjitet në shoqëri, duke arritur në funksione të larta shtetërore si deputetë, ministra e presidentë, por që kanë shkëlqyer e shkëlqejnë njëkohësisht në fushat e shkencës, në diplomaci, në sporte e në fushën e artit. Duke qenë me ta e mes tyre, si një edukatore e administratore, pata fatin që t’i njoh nga afër dhe të ndjej kënaqësinë për sukseset e tyre në jetë. Dua të veçoj në këtë rast faktin që janë me dhjetëra skënderbegas që u bënë shkrimtarë, poetë, piktorë apo artistë të njohur, të cilëve unë sa mundësi kisha, i kam ndihmuar duke u shtypur materialet në makinë shkrimi apo dhe duke i inkurajuar në udhën e bukur por të vështirë të artit. Nga kjo shkollë kanë dalë Hysni Milloshi, Apostol Duka, Robert Përmeti, Fejzo Lala, Shpend Topollaj, Kujtim Boriçi, Arben Duka, Ferit Fixha, e dhjetëra të tjerë që sot kanë bërë emër në fushën e artit. Me kalimin e viteve, pas ndryshimeve politike, në vitet 1990-1991, fatkeqësisht, një urdhër absurd çoi në mbylljen e kësaj shkolle me emër. Unë në atë kohë, vazhdoja të isha në detyrë dhe bashkë me dhjetëra

mësues, ushtarakë e qindra skënderbegas, e përjetuam keq këtë fakt. Por peripecitë vazhduan. Në proceset demokratike të atyre viteve, nuk munguan dhe absurde të tjera, deri dhe vandalizëm mbi institucione e arkiva, duke i identifikuar si ‘pjesë e së keqes’ së monizmit. Të nxitur dhe nga pohimi i kreut të shtetit në atë kohë se shkolla “Skënderbej” ishte “Shkollë jeniçerësh”, objekt i vandalizmit u bë dhe ky institucion.

U tentua që të shkatërrohej arkivi i shkollës, por një gjë të tillë unë nuk mund ta lejoja me çdo mjet. Nuk mund të lejoja një gjë të tillë, pasi shkatërrimi i një pjese të historisë, ishte e rëndë dhe e pafalshme për brezat. Pse ta mohoj, në këtë vendim, e dija që mund të rrezikoj dhe shumë rëndë. Por nuk kisha zgjidhje tjetër. Në momentin më të përshtatshëm, hipa në makinë dokumentet dhe i dërgova në shtëpi. Aty i ruajta shumë kohë, derisa situata u qetësua dhe kundrejt procesverbalit, i dorëzova në Arkivin Qendror të Ushtrisë. Kam marrë shumë falënderime, por e ndjej se thjeshtë bëra detyrën...

Sot, takoj me dhjetëra skënderbegas... Vijnë nga Amerika, Gjermania, Kanadaja, ku janë në emigracion. Më flasin në emër, flasin gjatë e ndjej kënaqësi...

Sigurisht, unë nuk ua mbaj mend të gjithëve emrat, se ata që kanë studiuar në këtë shkollë janë me dhjetëra mijë, por skënderbegasit e njohin njeri-tjetrin, i njohin dhe i respektojnë edukatorët e tyre...”, - përmbyll kujtimet e saj, Arta Reveli, kjo zonjë ‘arkivë’ e gjallë e shkollës “Skënderbej”.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Bajram Curri ishte udhëheqës popullor, ushtarak, senator i Senatit të Dhomës së Këshillit Kombëtar të Shqipërisë, nga 27 marsi 1920 deri më 20 dhjetor 1920. Dëshmor i Atdheut, Hero i Popullit shqiptar nga Malësia e Gjakovës, Bajram Curri e filloi veprimtarinë ushtarake si kapiten në Prizren, major në Prishtinë, e më tej kolonel (allajbeg) në Shkup, ku kishte në dorë xhandarmërinë e Vilajetit të Kosovës.

